



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
VLORË

NR. 378 AKTI  
Dt. 26.08.2014

NR. 378 VENDIMI  
Dt. 27.08.2014

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë prej:

GJYQTAR

FLORJAN KALAJA

Me sekretare gjyqësore znj. **Danajda Zanaj**, në seancën gjyqësore të datës 27.08.2014 i dha fund gjykimit të çështjes penale Nr. 378 Akti që u përket:

- Kërkuesi:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori i seancës **[REDACTED]**
- Vepra Penale:** "Mosdeklarimi i zotërimit ose mbajtjes" dhe "Zhvendosja ose përdorimi i mjetit pa autorizim" të parashikuar nga neni 23 dhe 29 i Ligjit Nr. 8663, dt. 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT" i ndryshuar
- Objekti:** Konfiskimin e sendit të sekuestruar: një motor deti tip "Yamaha" me fuqi motorike 110 hp me nr. serial US-YAMA3810C606 me ngjyrë vishnje.

*Gjykata, pasi çeli seancën gjyqësore, vërejtë se:*

I. **Rrethanat e çështjes**

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë mbi bazën e materialit të ardhur nga policia gjyqësore ka regjistruar procedimin penal Nr. 1401, dt. 14.08.2014 për veprat penale "Mosdeklarimi i zotërimit ose mbajtjes" dhe "Zhvendosja ose përdorimi i mjetit pa autorizim" të parashikuar nga neni 23 dhe 29 i Ligjit Nr. 8663, dt. 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT", i ndryshuar.

Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se me datë 11.08.2014 nga kontrolli i ushtruar nga shërbimet e Policisë Kufitare të Stacionit PKM Dhërmi në vendin para Hotelit **[REDACTED]** është konstatuar një mjet lundrues motor deti me ngjyrë vishnje me mbishkrimin "Yamaha" me të dyja krahët e pamatrikulluara, me gjatësi 3.32 m dhe gjërësi 1.15 m, i cili drejtohej nga një minorene ndërsa pronësia mbahet në emër të **[REDACTED]**. Ka rezultuar se ky mjet lundrues, pavarësisht se është pajisur me certifikatë përdorimi për mjet lundrues, nuk është i matrikulluar dhe regjistruar pranë autoriteteve kompetente. Për këto arsye mjete lundrues është sekuestruar nga autoritetet policore nëpërmjet procesverbalit dt. 12.08.2014.

Sakaq, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka kërkuar, në bazë dhe për zbatim të nenit 2, 7 dhe 23 të Ligjit Nr. 8663, dt. 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT", i ndryshuar, konfiskimin e mjetit lundrues të individualizuar më lart.

## II. Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se kërkesa objekt gjykimi është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet. Gjykata konstaton se në kuptim të nenit 2 të Ligjit Nr. 8663, dt. 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT", i ndryshuar mjeti motorik lundrues i individualizuar më lart përmbush kriteret ligjore si nga aspekti sasior dhe nga aspekti cilësor. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se në bazë dhe për zbatim të nenit 6 të këtij ligji ekziston detyrimi ligjor për të regjistruar mjetin pranë autoriteteve shtetërore. Njëkohësisht, duke patur parasysh se sipas nenit 23 të këtij ligji mosdeklarimi i zotërimit apo mbajtjes së mjetit përbën kundravajtje penale, në bazë dhe për zbatim të nenit 23/3 i këtij ligji Gjykata duhet të urdhërojë konfiskimin e mjetit lundrues motor deti me ngjyrë vishnje me mbishkrimin "Yamaha" me të dyja krahët e pamatrikulluara, me gjatësi 3.32 m dhe gjërësi 1.15.

Sakaq, Gjykata u tërhoq në Dhomën e Këshillimit dhe si u kthye, në bazë dhe për zbatim të nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 23/3 të Ligjit Nr. 8663, dt. 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT", i ndryshuar:

### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konfiskimin e mjetit lundrues motor deti me ngjyrë vishnje me mbishkrimin "Yamaha" me të dyja krahët e pamatrikulluara, me gjatësi 3.32 m dhe gjërësi 1.15.
3. Ngarkohet prokurori dhe policia gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Kundra këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Vlorë.

U shpall në Vlorë në datë 27.08.2014.

SEKRETARE  
DANAIDA ZANAJ



Kancelare  
Rezarta Jaushani



GJYQTAR  
FLORJAN KALAJA



Vendimi mori formë të prerë  
pasi nuk u ankimua  
më dt. 08.09.2014  
Vlorë më dt. 09.09.2014

K / sekretare

